



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*  
*Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance*

**Procesi i përzgjedhjes së përfaqësuesëve të shoqërisë civile në Këshillin për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile**

Përfaqësuesit e shoqërisë civile në Këshillin për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile do të nominohen dhe zgjedhen nga vet organizatat e shoqërisë civile, ndërsa i gjithë procesi do të organizohet nga Platforma CiviKos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit (ZQM/ZKM). Shoqëria civile përfaqësohet në Këshill me pesëmbëdhjetë (15) përfaqësues, nga të cilët një (1) emërohet nga Platforma CiviKos ndërsa katërmëdhjetë (14) të tjerë zgjedhen nga vet organizatat e shoqërisë civile.

Procesi i përzgjedhjes do të synojë balancin në mes të:

- 1. Përfaqësimit** - duke u dhënë mundësinë OshC-ve që të nominojnë kandidatë/e nga radhët e tyre ose të OshC-ve tjera sektoriale si dhe duke inkurajuar nominimin e grave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nën-përfaqësuar;
- 2. Ekspertizës** - duke përcaktuar kriteret minimale që duhet të plotësohen nga të nominuarit, si dhe nga OshC-të nominuese.

**Kriteri kryesor për të nominuarit** përcakton që: i nominuari duhet të ketë përvojë të dëshmuar pune në fushën e caktuar; dhe të jetë i angazhuar në një OshC për të paktën 3 vite të fundit është e profilizuar në sektorin e caktuar.

**Kriteri kryesor për nominuesit (OshCtë që bëjnë nominime)** përcakton që: OSHC-ja të ekzistojë të paktën gjatë 3 viteve të fundit.

E gjithë procedura e nominimit dhe përzgjedhjes menaxhohet nga Sekretariati i Platformës CiviKos nëpërmjet Formularëve për Nominim dhe Formularëve për Votim, ku përcaktohen qartë të gjitha kushtet e kërkuara dhe dokumentet shtesë. Një panel verifikues i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos dhe një përfaqësues i ZQM/ZKM konfirmojnë plotësimin e kriterëve të të nominuarëve, para zyrtarizimit të listës përfundimtare për votim. Të drejtë për të votuar për kandidatët e nominuar kanë të gjitha OshC-të e regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ.